

# FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

## Sika MonoTop®-111 AntiCorrosion

MBROJTJE KUNDËR KORRODIMIT TË ARMATURËS DHE PRAJMER PËR NGJITJE



### PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika MonoTop®-111 AntiCorrosion është llaç çimentoje prej 1 përbërësi, i modifikuar me polimere dhe me përmbajtje tymi silici që përdoret si mbrojtje kundër korrodimit të armaturës dhe si prajmer për ngjitje.

### PËRDORIMET

- Mbrojtje kundër korrodimit të armaturës për riparimet e betonit
- Prajmer për ngjitje mbi beton dhe llaç

### KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Përzierje e lehtë, thjesht shtoni ujë
- Aplikim miqësor ndaj mjedisit
- Ndërkapje e shkëlqyer mbi beton dhe çelik
- Rezistencë e lartë ndaj depërtimit të ujit dhe klorureve
- Rezistenca mekanike të mira
- Aplikim me furçë ose pistoletë spërkatjeje

### MIRATIME / STANDARDE

Llaç për mbrojtje kundër korrodimit për riparimin dhe mbrojtjen e betonit sipas EN 1504-7:2006, Deklarata e Performancës: 44908616, certifikuar nga organi i njoftuar i certifikimit të kontrollit të prodhimit në fabrikë 0546, certifikatë pajtueshmërie të kontrollit të prodhimit në fabrikë 18774 dhe mbart markimin CE.

### INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

|                       |  |
|-----------------------|--|
| Baza kimike           | Çimento, agregate të përzgjedhura dhe aditivë.   |
| Ambalazhi             | Kuti me 10 qese alumini, 2 kg/ qese  |
| Paraqitja / Ngjyra    | Pluhur gri - i gjelbër   |
| Jetëgjatësia          | 15 muaj  |
| Kushtet e magazinimit | Të ruhet në ambalazhin origjinal, të padëmtuar dhe të mbyllur, në kushtë të thata dhe të freskëta. |
| Dendësia              | Dendësia e llaçit të freskët: ~2.05 kg/l   |

### TË DHËNA TEKNIKE

|                                     |                        |            |
|-------------------------------------|------------------------|------------|
| Rezistenca ndaj ngjeshjes           | ~40 MPa pas 28 ditësh  | (EN 12910) |
| Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje | ~2.6 MPa pas 28 ditësh | (EN 1542)  |

## INFORMACIONE MBI SISTEMIN

|                             |  |
|-----------------------------|--|
| <b>Struktura e sistemit</b> | Sika MonoTop®-111 AntiCorrosion është pjesë e Sistemit Sika për riparime, sipas Standardit Europian EN 1504 dhe përfshihen këto produkte:<br>Sika MonoTop®-111 AntiCorrosion: prajmer dhe mbrojtje kundër korrodimit të armaturës;<br>Seria Sika MonoTop®: Ilaçe për riparime strukturore. |
|-----------------------------|--|

## INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

|                                  |   |
|----------------------------------|---|
| <b>Raporti i përzjerjes</b>      | ~0.46 litra uji për çdo qese 2 kg.  |
| <b>Konsumimi</b>                 | <b>Mbrojtje kundër korrodimit të armaturës:</b><br>Për udhëzim, ~1.7 kg pluhuri për m <sup>2</sup> për 1mm trashësi shtrese (në total min. 2 shtresa)<br><b>Prajmer për ngjitje:</b><br>Varet nga ashpërsia e nënshtresës dhe trashësia e shtresës së aplikuar. Për udhëzim, ~1.5 – 2.0 kg pluhuri për m <sup>2</sup> për mm trashësie. Trashësia 1.2-1.7 mm. |
| <b>Rendimenti</b>                | 2 kg pluhuri prodhon afërsisht 1.2 litra Ilaçi.   |
| <b>Temperatura e mjedisit</b>    | +5 °C min. / +35 °C max.  |
| <b>Temperatura e nënshtresës</b> | +5 °C min. / +35 °C max.  |
| <b>Koha e punueshmërisë</b>      | ~30 minuta në + 20 °C   |

## UDHËZIME APLIKIMI

### CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

#### Armatura

Ndryshku, Ilaçi, betoni, pluhuri dhe kontaminime të tjera ose materiale të shkrifëta të cilat mund të reduktojnë ngjitjen apo të shkaktojnë korrodimit duhet të hiqen.

Sipërfaqet duhet të përgatiten me teknika abrazive pastrimi ose me curril uji në presion të lartë.

#### Betoni

Betoni duhet të mos ketë pluhur, grimca të lira, kontaminime sipërfaqësore dhe materiale të cilat do të reduktojnë ngjitjen ose do të parandalojnë përthithjen apo lagjen nga materialet për riparim. Betoni i shpetëzuar, i dobët, i dëmtuar, dhe kudo nevojitet, betoni i shëndetshëm duhet të hiqet me mjetet e përshtatshme.

Sipërfaqja duhet të laget deri në saturim, duke shmangur grumbullimin e ujit. Sipërfaqja duhet të ketë paraqitje të errët mat pa shkëlqim dhe poret e sipërfaqes nuk duhet të përmbajnë ujë.

### PËRZIERJA

Sika MonoTop®-111 AntiCorrosion mund të përzihet me një mikser elektrik në shpejtësi të ngadaltë (<500 r.p.m). Në sasi të vogël, Sika MonoTop®-111 AntiCorrosion mund të përzihet edhe me dorë. Hidhni ujin në raportin e rekomanduar brenda një konteineri të përshtatshëm për përzjerje. Ndërsa jeni duke përzierë ngadalë, shtoni pluhurin tek uji dhe përzieni plotësisht derisa të arrihet konsistenca e kërkuar (konsistencë jo rrjedhëse për lyerje me furçë).

### APLIKIMI

#### Si mbrojtje për armaturën

Aplikoni shtresën e parë me trashësi ~1 mm, duke përdorur furçë me fortësi mesatare mbi armaturën të pastruar nga pluhuri. Kur shtresa e parë të jetë tharë (e fortë në prekje me thoin e gishtit, për udhëzim ~4 deri 5 orë në 20°C), aplikoni shtresën e dytë me trashësi ~ 1 mm.

#### Si prajmer

Aplikoni me furçë, rul ose pajisje të përshtatshme për spërkatje mbi nënshtresën e përgatitur (të lagur). Për të arritur ngjitje të mirë, Sika MonoTop®-111 AntiCorrosion duhet të aplikohet mirë mbi nënshtresë, duke mbushur të gjitha paparazitë.

Ilaçi vijues për riparim duhet të aplikohet ndërsa prajmeri është ende i lagësht.

### MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

### KUFIZIME

- Referohuni në "Method Statement" për riparimin e betonit duke përdorur sistemin Sika® MonoTop® për më shumë informacione rreth përgatitjes së nënshtresës ose referohuni tek rekomandimet që jepen në EN 1504-10
- Shmangni aplikimin në diell të drejtpërdrejtë dhe/ose erë të fortë dhe/ose shi
- Mos shtoni ujë mbi dozën e rekomanduar
- Aplikoni vetëm mbi nënshtresa të qëndrueshme dhe të përgatitura
- Mbroni materialin e sapoaplikuar nga ngrirja

## BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

## KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

## EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

## SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla saqë asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

### Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park  
Ndërtesa nr. 7, kati 4  
Tiranë - Shqipëri  
Tel.: +355 4 454 0070  
alb.sika.com  
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit  
Sika MonoTop®-111 AntiCorrosion  
Shkurt 2019, Botimi 01.01  
020302020010000047

SikaMonoTop-111AntiCorrosion-sq-AL-(02-2019)-1-1.pdf